

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7031
E enjte, 26 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

Gjermania, dëbime më të shpejta për ata pa leje qëndrimi



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT (E ENJTE) KURTI DHE VUÇIQI, ME FTESË TË BASHKIMIT EVROPIAN, DO TË QËNDROJNË NË BRUKSEL

TENTIMI PËR RIKTHIM NË DIALOG, TEMË E 'NXEHTË' PROPOZIMI I RI PËR ASOCIACIONIN



Sy e veshë do të jenë të enjten në Bruksel. Atje do të qëndrojnë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Për herë të parë pas 42 ditësh, ata do të jenë sërish

në kryeqendrën evropiane me ftesë të Bashkimit Evropian. Dy udhëheqësit pritet të takojnë veç e veç edhe presidentin e Francës, Emmanuel Macron, kryeministren e Italisë, Giorgia Meloni,

kancelarin e Gjermanisë, Olaf Scholz, dhe shefin e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell. Takimet e tyre do të zhvillohen në margjinat e një samiti të BE-së

OPINION

BABA I BASHKIMIT KOMBËTAR APO I ASOCIACIONIT F.7

Shkruan:
Bekim ÇOLLAKU




AKTUALE



NË KUFİ ME SERBINË SEKUESTROHEN 182 KG MARIJUANË NË VLERË RRETH 400 MIJË EURO F.6

IZRAELI I ASHPËRSON BOMBARDIMET NË GAZË F.2

EKONOMI



HAPET PANAIRI I PRODUKTEVE BUJQËSORE F.8

KRYETARI I BSPK-SË: AGJENDËN E GJELBËR TA HARMONIZOJMË ME PARIMET E DREJTËSISË SOCIALE F.8

SPORT



KONJUFCA TAKOHET ME DUKËN: KOMBËTARJA E SHOIPËRISË NA KA BËRË KRENARË TË GJITHËVE F.10

KOSOVA DHE IOWA PRITET TA THELLOJNË BASHKËPUNIMIN NË ARSIM, EKONOMI DHE BUJQËSI



DEPUTETI NGA ESTONIA KËRKON NGA KOSOVA DHE SERBIA TË PUNOJNË PËR SHPËRSHKALLËZIM TË SITUATËS NË VERI



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli i ashpëron bombardimet në Gazë

JERUSALEM, 25 TETOR - Ushtria e Izraelit i ka ashpërsuar bombardimet në jug të Rripit të Gazës të mërkurën, një ditë pas njëres prej ditëve më vdekjeprurëse për palestinezët që kur nisi konflikti, pavarësisht prej thirrjeve të liderëve botërorë për ndaljen e luftimeve për ta mundësuar futjen e ndihmave humanitare në enklavën e rrethuar.

Shtetet e Bashkuara dhe Rusia po u prijnë thirrjeve ndërkombëtare për një ndërprerje në luftimet mes Izraelit dhe Hamasit, në mënyrë që të lejohet dërgimi i ndihmave në Gazë, ku palestinezët po jetojnë në kushte të tmerrshme.

Mbi 700 palestinezë, përfshirë 305 fëmijë, u vranë të martën, sipas Ministrisë së Shëndetësisë së Gazës, e

cila udhëhiqet nga Hamasi. Sipas Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Çështje Humanitare, ky është numri më i lartë i të vvarëve brenda një dite që kur filluan luftimet tri javë më parë. Izraeli i nisi bombardimet në Gazë më 7 tetor, pasi militantët e Hamasit i sulmuan qytetet e Izraelit jugor duke i vvarë 1 400 njerëz, kryesisht civilë.



Gjermania, dëbime më të shpejta për ata pa leje qëndrimi

BERLIN, 25 TETOR - Dëbime konsekuente. Që në shkurt kancelari gjerman Olaf Scholz ka bërë me dije në Bundestag se "kush nuk ka këtu të drejtë qëndrimi, ai duhet të largohet nga Gjermania". Por është më e lehtë të thuhet se të veprohet. Së fundmi në Gjermani jetonin rreth 280 000 veta që nuk kishin leje qëndrimi dhe duhet të largoheshin nga Gjermania. Por në katër nga pesë raste dëbimi është pezulluar. Shumica e këtyre personave kanë llojin e lejes Duldung, për shembull për shkak të gjendjes së sigurisë në vendin e tyre, sepse janë të sëmurë ose u mungojnë dokumentet. Nga ana tjetër, shumë dëbime nuk arrihen të kryhen, sepse personat që duhet të dëbohen, fshihen.

Në verë ministrja e Punëve të Brendshme e Gjermanisë, Nancy Faeser, paraqiti idetë e para se si mund të bëhen më efektive dëbimet. Para dy javësh politikania socialdemokrate prezantoi draftin e projektligjit. Të mërkurën kabineti qeveritar gjerman miraton rregulloren të reja për dëbime më të shpejta të migrantëve pa të drejtë qëndrimi.

Në të parashikohen një sërë masash: Më shumë kompetenca për policinë dhe më shumë kohë për autoritetet për përgatitjen e dëbimeve. Kështu ata që duhet të dëbohen nga Gjermania mund të mbahen më gjatë në të



ashtuquajturin "Abschiebehaft" - burgim për një kohë të caktuar, që nuk nënkupton dënim të personit, por përgatitjen e dëbimit - në 28 ditë jo 10 ditë si deri më tani. "Nga njëra anë kemi zgjatur ndalimin për shkaqe dëbimi. Kjo është sigurisht një pikë", tha Faeser. Nga ana tjetër kontrabandistët do të dëbohen më shpejt.

Përveç kësaj, policia merr të drejtën t'i kërkojë personat që janë të detyruar të largohen nga Gjermania në strehimoret e përbashkëta dhe në dhomat e bashkëbanorëve. Dhe në fund dëbimet e personave me detyrim largimi nuk do të

paralajmërohen më, përveç rasteve të familjeve me fëmijë nën 12 vjeç. Ministrja Faeser shpreson ta arrijë në këtë mënyrë uljen e migracionit ilegal. "Kjo do të ndihmojë", tha Faeser.

Koalicioni i dyzuar

Brenda partive të koalicionit qeverisës në Gjermani masat e parashikuara nuk kanë gjetur gjithmonë mbështetje. Kritika kanë ardhur nga disa pjesë të Partisë Socialdemokrate, SPD dhe Të Gjelbrit, si politikania Filiz Polat. "Sipas pikëpamjes sonë, këto janë ndërhyrje masive në të drejtat themelore. E drejta e

dëbimit duhet të ashpërsohet. Sipas qëndrimit tim, kjo është joproporcionale dhe shumë e rëndë".

Nga ana e partneres të vogël të koalicionit, Partisë Demokratët e Lirë, FDP dëgjohej tone miratuese. Për drejtuesin ekzekutiv të grupit parlamentar liberal, Stephan Thomaes, është e qartë. "Shteti duhet të krijojë edhe kushtet, që vendimet e tij të zbatohen".

Scholz kërkon mbështetjen e opozitës

Pas vendimit të qeverisë projektligji kalon në Bundestag.

Ndoshta edhe për shkak të devijuesve brenda radhëve të koalicionit, kancelari kërko mbështetjen e opozitës duke i drejtuar letër kreut të Partisë Kristiandemokrate, CDU, Friedrich Merz, për ta mbështetur këtë projektligj. Nga opozita janë dhënë sinjale të përmbajtura miratuese. "Ky është një hap i vogël në drejtimin e duhur", është shprehur drejtuesi ekzekutiv i grupit parlamentar CDU/CSU në Bundestag, Thorsten Frei.

AfD shikon konfirmim të politikës së saj, E Majta kritikon

Drejtuesja e AfD, Alice Weidel, i cilësoi planet e ministres së Brendshme si kopje të kërkesave të partisë së saj. "Nga një panik i qartë natyrisht merren tani edhe kërkesat e AfD-së". Kurse E Majta kritikon marrjen e narrativave të djathta në politikën e refugjatëve. Zëdhënësja për politikën e migrimit në partinë E Majta, Clara Bünger, shikon në këtë projektligj shkelje të proporcionalitetit dhe mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, veçanërisht të "dëbimet e paralajmëruara pas qëndrimit të gjatë". Për shkak se shumë vende refuzojnë të marrin të dëbuarit dhe marrëveshjet e ripranimit kërkojnë kohë të gjatë, nuk dihet ende se çfarë efekti do të kenë masat e ashpërsuara.

Navalny thotë se është futur sërish në izolim

MOSKË, 25 TETOR - Opozitari i burgosur rus, Aleksei Navalny, është vendosur në izolim një ditë pasi aleatët e tij thanë se autoritetet ia kanë hequr të drejtën që të shkruajë materiale, që është mënyra e vetme që ai komunikon me botën jashtë.

Përmes një postimi në llogarinë e Navalnyt në "X" u tha se kritiku i Kremlinit

do të qëndrojë 12 ditë në izolim, pasi një zyrtar i burgut i ka shqiptuar atij dënim për një shkelje. Megjithatë, ende nuk është e qartë se për çfarë shkelje bëhet fjalë. "Jam rikthyer në qelinë e ndëshkimit për 12 ditë. Baza e gjithë kësaj është një raport i një oficeri të burgut, në të cilin ai ka shkruar 'përderisa i kërkoja Navalnyt të dilte nga qelia

për të marrë një dyshek, ai më poshtëroi dhe më shau", shkruhet në postimin e Navalnyt. Zëdhënësja e Navalnyt, Kira Yarmysh, tha se kjo ishte hera e 21-të që opozitari rus është vendosur në izolim që kur është dërguar në burgun IK-6, 250 kilometra në lindje të Moskës, në gusht të vitit 2022.



MBAHET PUNËTORIA PËR VLERËSIMIN DHE MENAXHIMIN E RREZIKUT SIZMIK NGA TËRMETET NË KOSOVË

Kosova edhe në të ardhmen mund të goditet nga tërmete të forta

Kosova është një rajon me aktivitet relativisht të lartë sizmik, që është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete të forta, të cilët kanë vatra të cekëta, e që gjenerohen në koren e tokës, maksimumi 15-25 km thellë nën tokë. Sipas hartës së rrezikut sizmik, Kosova i ka tri zona kryesore burimore sizmike. Zona sizmike Prizren - Pejë, zona Ferizaj - Viti - Gjiilan dhe zona e Kopaonikut

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 TETOR - Shërbimi Gjeologjik i Kosovës (ShGjK), me mbështetjen e Programit IPA CARE - Cluster 2 Sizmic risk, mbajti punëtorinë ndërinstitucionale për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut sizmik. Gjatë konferencës u ofruan studime shkencore e harta sizmike për gjendjen sizmike të territorit të Republikës së Kosovës në aspektin historik, të cilat do të shërbejnë si një platformë e mundësisë së shkëmbimit të përvojave në aspektin e rrezikut sizmik, standardëve dhe kodeve për ndërtim.

U.d. i drejtorit të përgjithshëm të ShGjK-së, Luan Morina, ka theksuar se Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, konform legjislacionit në fuqi, ka përgjegjësinë institucionale për monitorimin dhe përgatitjen e informacionit përkatës për


aktivitet sizmike, informacione të cilat trajtohen më tutje nga institucionet relevante në nivel vendi.

Kurse nga Augostino Gorentti, nga IPA CARE-Cluster 2, u prezantua programi si dhe u elaboruan mundësitë për përcaktimin e prioriteteve për mbështetje nga institucionet relevante në Republikën e Kosovës.

Në vijim Shemsi Mustafa, udhëheqës i Divizionit të Gjeofizikës dhe Gjeologjisë Inxhinierike në ShGjK dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera, paraqitën informacionet dhe pikëpamjet shkencore për menaxhimin e riskut sizmik.

Kosova është një rajon me aktivitet relativisht të lartë sizmik, që është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete të forta, të cilët kanë vatra të cekëta, e që gjenerohen në koren e tokës, maksimumi 15-25 km thellë nën tokë.

Sipas hartës së rrezikut sizmik,



Kosova i ka tri zona kryesore burimore sizmike: zona sizmike Prizren - Pejë, zona Ferizaj - Viti - Gjiilan dhe zona e Kopaonikut. Në punëtori u paraqitën të dhënat historike të tërmeteve që kanë goditur territorin e Kosovës që nga viti 1456 deri më 31.09.2021. Tërmeti i parë i regjistruar është ai që e goditi Prizrenin në vitin 1456 dhe ishte një nga tërmetet më të fuqishme që është regjistruar në Kosovë, me magnitudë 6.1 të shkallës

Rihter, kurse tërmeti me magnitudë 6.0 e ka goditur Pejë në vitin 1662, ndërsa Ferizaj është goditur nga një tërmet i fuqishëm në vitin 1921, që ishte me magnitudë 6.1 të shkallës Rihter. Gjithashtu, tri tërmetet më të fuqishme që e kanë goditur Kosovën në vitet e fundit janë tërmeti që e goditi rajonin e Gjiilanit më 24.04.2002, me magnitudë 5.7 të shkallës Rihter, tërmeti i Istogut që ndodhi më 10.03.2010, me magnitudë 5.2,

kurse tërmeti që e goditi rajonin e Vushtrrisë ishte më 18.11.2013 me magnitudë 4.8. Në punëtori kanë marrë pjesë përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbrojtjes civile italiane, studiues të sizmologjisë nga Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Mitrovicës dhe komuna e Prishtinës.

Kosova dhe Iowa pritet ta thellojnë bashkëpunimin në arsim, ekonomi dhe bujqësi

PRISHTINË, 25 TETOR - Me ftesë të guvernatores së Iowas, presidentja Osmani ka nisur vizitën zyrtare në Iowa të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Presidentja Osmani dhe Zotëria i Parë, Prindon Sadriu, janë pritur me pritje ceremoniale nga guvernatorja e Iowas, Kim Reynolds dhe Zotëria i Parë, Kevin Reynold.

Osmani e ka falënderuar guvernatoren për pritjen dhe për vizitën bërë Kosovës në muajin qershor të këtij viti.

Gjatë takimit, presidentja Osmani ka theksuar se Kosova nuk ka aleate të mirë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilën, sipas saj, ndajnë vlera të njëjta të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Sipas presidentes Osmani, nënshkrimi kohë më parë i Programit të Partneritetit Shtetëror të Iowas përbën një element thelbësor të marrëdhënieve strategjike me Shtetet e Bashkuara. "Ky program luan një rol jetik në zhvillimin tonë të vazhdueshëm ushtarak dhe

përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve në përputhje me objektivat dhe aspiratat tona të sigurisë kombëtare për anëtarësim në NATO", ka theksuar Osmani.

Më tej, presidentja Osmani ka shtruar nevojën e ndihmës substanciale ekonomike dhe programet e zhvillimit të iniciuara nga Shtetet e Bashkuara për ta mbështetur rritjen dhe stabilitetin ekonomik të Kosovës.

Në takim me guvernatoren Reynolds është diskutuar për shkëmbime të mëtejshme studentore, bursa dhe bashkëpunime akademike ndërmjet universiteteve të Kosovës dhe Iowas, duke përfshirë shkëmbimin në fakultete, projekte të përbashkëta kërkimore dhe iniciativa për ngritjen e kapaciteteve në arsim.

Është diskutuar edhe për mundësinë e shkëmbimit të njohurive, transferimin e teknologjisë bujqësore dhe bashkëpunimin në praktikën e qëndrueshme bujqësore, ku në kuadër të këtij bashkëpunimi do të përmirësohen edhe më tej lidhjet



ekonomike me shtetin e Iowas. Me qëllim që të përforcohet ky bashkëpunim, pjesë e delegacionit të presidentes është edhe ministri i Bujqësisë, Faton Peci. Presidentja Osmani, ndër të tjera, e

ka njoftuar guvernatoren lidhur me zhvillimet e fundit në Kosovë, pas aktit të agresionit që Serbia ka kryer në Republikën e Kosovës më 24 shtator.

Sipas presidentes Osmani, Kosova

do ta vazhdojë bashkëpunimin me aleatë, ndërkohë që autorët e sulmit terrorist dhe aktit të agresionit ndaj Republikës së Kosovës të kryer më 24 shtator duhet të vihen para përgjegjësisë.



SOT (E ENJTE) KURTI DHE VUÇIQI, ME FTESË TË BASHKIMIT EVROPIAN, DO TË QËNDROJNË NË BRUKSEL

Tentimi për rikthim në dialog, temë e 'nxehtë' propozimi i ri për asociacionin

Sy e veshë do të jenë të enjten në Bruksel. Atje do të qëndrojnë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Për herë të parë pas 42 ditësh, ata do të jenë sërish në kryeqendrën evropiane me ftesë të Bashkimit Evropian. Dy udhëheqësit pritet të takojnë veç e veç edhe presidentin e Francës, Emmanuel Macron, kryeministren e Italisë, Giorgia Meloni, kancelarin e Gjermanisë, Olaf Scholz, dhe shefin e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell. Takimet e tyre do të zhvillohen në margjinat e një samiti të BE-së

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është pajtuar që plani i emisarëve perëndimorë, i paraqitur ditë më parë, të jetë kornizë për bisedimet e mëtejshme me Shtetet e Bashkuara, Gjermaninë, Francën dhe Italinë. Kështu ka bërë me dije Qeveria e Kosovës, duke e konfirmuar pjesëmarrjen e Kurtit në takimet e 26 tetorit në Bruksel.

Të enjten Kurti dhe presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiq do t'i takojnë veç e veç presidentin e Francës, Emmanuel Macron, kryeministren e Italisë, Giorgia Meloni, kancelarin e Gjermanisë,

Olaf Scholz, dhe shefin e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell. Ata janë ftuar në Bruksel katër ditë pasi emisarët perëndimorë i kanë kërkuar Kosovës dhe Serbisë t'i normalizojnë marrëdhëniet në disa takime që i kanë zhvilluar në Prishtinë dhe Beograd.

Bashkimi Evropian i ka cilësuar si "mbështetje" për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë takimet e së enjtes në margjinat e samitit të BE-së, ku janë ftuar kryeministri Albin Kurti dhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq.

Kurti dhe Vuçiqi e kanë konfirmuar pjesëmarrjen në takimet ndarëse me liderët kryesorë evropianë, të cilat, sipas zëdhënësit të BE-së,

Peter Stano, nuk janë të nivelit të lartë. "Takimet janë në mbështetje të kthimit në dialog dhe ky është mesazhi. Presim nga të dyja palët që menjëherë dhe pa kushte t'i kthehen përmbushjes së obligimeve nga dialogu", ka theksuar Stano të mërkurën, duke shtuar se diskutimet e të dërguarit të posaçëm të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, gjatë fundjavës në Beograd dhe Prishtinë, ishin të fokusuar në zbatimin e Aneksit të Ohrit. "Nuk ka ndonjë qëllim që ai të zëvendësohet. U diskutuan propozime dhe ide të ndryshme - disa me shkrim - dhe këto diskutime do të vazhdojnë. Kjo, po ashtu, përfshin edhe një propozim modern evropian për statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe", ka pohuar Stano. Gjatë takimit në Prishtinë përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian (BE) për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, ka thënë se me Kurtin ka diskutuar për një plan. Qeveria ka thënë se takimi do të jetë "në kuptim të diskutimeve të nisura me pesë emisarët në të cilin ata propozuan një plan të ri që përfshinte një paketë më të plotë të zbatimit gjithëpërfshirës të

Marrëveshjes Bazike bashkërisht me një draft të propozuar për zbatimin e nenit 7".

Qeveria i është referuar Marrëveshjes për normalizim marrëdhëniesh, të arritur mes dy vendeve në shkurt të këtij viti në Bruksel. Dy palët më vonë janë marrë vesh për aneksin e zbatimit, në mars, në Ohër.

Çfarë thotë Neni 7?

Të dyja palët janë të përkushtuara për arritjen e marrëveshjeve specifike dhe garancive, në përputhje me instrumentet përkatëse të Këshillit të Evropës dhe duke përdorur përvojat ekzistuese evropiane, për të siguruar një nivel të përshtatshëm të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe mundësinë e ofrimit të shërbimeve në disa fusha specifike, përfshirë mundësinë e ndihmës financiare nga Serbia dhe kanalet e drejtpërdrejta të komunikimit të komunitetit serb me Qeverinë e Kosovës.

Gjatë takimeve në Kosovë dhe Serbi të pesë diplomatët nga BE-ja, Shtetet e Bashkuara, Franca, Italia dhe Gjermania, sipas bllokut evropian, palëve u është paraqitur

një "propozim modern evropian për statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe", tha zëdhënësi i BE-së, Peter Stano më 24 tetor.

Komuniteti ndërkombëtar po u bën thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i kthehen dialogut që ndërmjetësohet nga BE-ja pas rritjes së tensioneve mes dy shteteve. Tensionet janë rritur qysh në maj në komunat veriore të Kosovës, pasi serbët lokalë kundërshtojnë kryetarët e rinj shqiptarë, që dolën nga zgjedhjet e prillit - të bojkotuar nga serbët.

Më 24 shtator tensionet u përshkallëzuan pasi Policia e Kosovës u sulmua nga një grup i armatosur i serbëve, ku vdiq polici Afrim Bunjaku. Gjatë përleshjeve u vranë edhe tre sulmues serbë.

Kosova ka fajësuar Serbinë për sulmin, por Beogradi ka mohuar përfshirjen në të.

Asociacioni është ndër pikat më të nxehta në dialogun për normalizimin e marrëdhëniesh në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Në Beograd insistojnë në kompetenca të gjera për këtë asociacion, ndërsa në Prishtinë thonë se të tillat do ta rrezikojnë funksionalitetin e shtetit.

Sveçla dhe Roosemont biseduan për sfidën e menaxhimit të migrimit të parregullt

PRISHTINË, 25 TETOR - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka pritur të mërkurën në takim drejtorin e Zyrës për Migrim nga Mbretëria e Belgjikës, Freddy Roosemont dhe ambasadorin e Belgjikës, Gregoire Cuvelier, me të cilët ka biseduar për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës që hyn në fuqi nga data 1 janar 2024.

Sipas njoftimit të MPB-së, Roosemont i përgëzoi qytetarët e Republikës së Kosovës që nga data 1 janar do të lëvizin pa viza drejt Belgjikës dhe shteteve të Bashkimit Evropian dhe theksoi që kjo do të jetë një mundësi e mirë për zhvillim ekonomik dhe thellim të lidhjeve mes shteteve dhe qytetarëve.

Ministri Sveçla falënderoi Roosemontin për mbështetjen e vazhdueshme të Mbretërisë së Belgjikës për Republikën e Kosovës dhe shprehu gatishmërinë për thellim të bashkëpunimit edhe në fusha të tjera. Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar tashmë



fushatën njoftuese në të gjitha komunat dhe për të gjithë qytetarët mbi procedurat dhe kriteret e lëvizjes së lirë nga data 1 janar 2024. Ministri Sveçla dhe Roosemont

biseduan edhe për sfidën e menaxhimit të migrimit të parregullt me ç'rast ministri njoftoi delegacionin që institucionet e Republikës së Kosovës janë të

angazhuara maksimalisht për luftimin e këtij fenomeni, duke përfshirë edhe rregullativën ligjore për menaxhimin e migrantëve. Republika e Kosovës dhe

Mbretëria e Belgjikës gëzojnë marrëdhënie të shkëlqyera dypalëshe dhe mbesin të përkushtuara që këto raporte të vijojnë edhe më tutje.



Ndahet skema e parë e granteve për certifikimin e produkteve për bizneset në vlerë 400 mijë euro

PRISHTINË, 25 TETOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ka filluar zbatimin e Politikës Industriale sipas analizës së performancës industriale dhe studimeve të zinxhirëve të vlerës për zhvillim industrial, duke mbështetur bizneset për certifikimin e produkteve që kanë

për qëllim eksportin përmes skemës financiare të granteve. Në fazën e parë të kësaj skeme përfituan gjithsej 10 biznese derisa vlera e granteve të dhëna është 400 000.00 euro. Nga marrëveshjet e nënshkruara përmes kësaj skeme bizneset do të përfitojnë menjëherë 80 % të mjeteve, pjesa tjetër prej 20 % do të realizohet atëherë kur bizneset ta përfundojnë procesin e

certifikimit të produkteve për eksport. Grantet u nënshkruan nga sekretari i MINT, Daut Latifaj, ndërkaq për një fjalë rasti ministria Rozeta Hajdari para përfaqësuesve të bizneseve tha se politika industriale, zbatimi i së cilës po nis suksesshëm, ka krijuar një momentum të ri për bizneset tona, duke i përgatitur prodhimet vendore për tregun ndërkombëtar.

Udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë u takuan për herë të fundit më 14 shtator.

Konjufca: Propozimi për Asociacionin, plotësisht në përputhje me Kushtetutën

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë të mërkurën se propozimi i Bashkimit Evropian, i cilësuar si propozim modern evropian për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, duket se është në përputhje të plotë me Kushtetutën. Gjatë një prononcimi për media në Prishtinë, Konjufca tha se për Asociacionin nuk duhet të negociohet dhe ai nuk duhet të jetë temë qendrore e negociatave, pasi për të është arritur më herët marrëveshje. "Në një shikim

sipërfaqësor, po [propozimi për Asociacionin] është plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe kurrfarë niveli i pushtetit në Kosovë. Por, edhe kjo nuk mendoj që është temë e negociatave me Serbinë. Nëse ndonjëherë ndodh ndonjë draft i asociacionit, ai do të propozohet nga Republika e Kosovës, nëse veç ndodh. Nëse jo, nuk do të propozohet fare", ka deklaruar Konjufca.

'Ka, s'ka...', Çitaku ironizon me konfuzionin e qeverisë për dialogun dhe asociacionin

Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka reaguar pas disa deklaratave të fundit të Qeverisë së Kosovës për dialogun apo nëse do ta pranojë apo jo Asociacionin e

Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Çitaku në rrjetin social "Facebook" ka shkruar se Qeveria e Kosovës është duke krijuar konfuzion dhe panik në vend. "E kemi pranuar planin. Jo nuk e kemi pranuar planin. Nuk ka dialog pa u ndëshkuar Serbia. Ka dialog me Serbinë këtë javë. Ka asociacion. Asociacioni ka vdekur. Ka s'ka, ka s'ka, ka s'ka. Kakofoni. Konfuzion. Panik", ka shkruar Çitaku.

KMDLNj: Kurti ta informojë Kuvendin për ecurinë e bisedimeve dhe propozimet që i janë bërë nga 'Pesëshja e madhe'

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut ka theksuar

në një reagim se është koha e fundit që kryeministri Albin Kurti t'u drejtohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës, si përfaqësues të zgjedhur të popullit, dhe t'i informojë për ecurinë e bisedimeve dhe propozimet që i janë bërë nga 'Pesëshja e madhe' pas së cilës do ta kërkonte përkrahjen e tyre për ndërtimin e një konsensusi politik, kombëtar dhe shtetëror.

Sipas KMDLNj-së, Kurti e zgjodhi gjuhën e peshkut - gjuhën e heshtjes, që në opinion ngjalli shumë dyshime për porosinë që e solli "Pesëshja e madhe" në Prishtinë. "Qeveria e Kosovës, përkatësisht KM Kurti është qeveria dhe KM më jotransparent, sidomos sa i përket bisedimeve me Serbinë duke mos i dhënë llogaridhënie askujt, madje as deputetëve të Kosovës e që e kanë të detyruar ta bëjnë këtë. Nuk duhet të kthehemi shumë kohë prapa e të bëjmë

krahasime se sillej LV-ja sa ishte në opozitë në Kuvendin e Kosovës me anëtarët e delegacionit që bënte negociata me Serbinë; nuk linte mjet pa përdorur për të kundërshtuar këto bisedime sikur që sulmonte me të gjitha mjetet e mundshme, të dhunshme kryesisht, anëtarët e delegacionit duke i akuzuar për mungesë të transparencës dhe llogaridhënies. Qeveria aktuale me KM Kurti në krye, mungesën e transparencës dhe llogaridhënies e mbështjellin me një mbështjellëse që mbulon çdo gjë përveç të vërtetës, me ruajtjen e parimit e konfidencialitetit dhe kërkesën e ndërkombëtarëve që të mos flitet në publik për këtë. Arsyetim amortizues për marrëveshje që kanë prodhuar dhe do të prodhojnë pasoja të dëmshme për Kosovën", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Studentët e UP-së njoftohen me praktikat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

PRISHTINË, 25 TETOR - Universiteti i Prishtinës ka organizuar tryezë diskutimi me juriskonsulentin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe studentët e programit master "Të drejtat e njeriut, e drejta penale ndërkombëtare dhe drejtësi tranzicionale". Qëllimi i tryezës ishte të diskutonte me studentët praktikat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), rolin kryesor të juriskonsulentëve brenda GJEDNJ-së, sigurimin e cilësisë së gjyqimeve dhe

vendimeve nga GJEDNJ, kontributet në zhvillimin dhe përhapjen e jurisprudencës nga gjykata dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut nëpër vendet evropiane. Studentët tanë, të cilët filluan këtë program unik, u përgëzuan për angazhimin e tyre dhe përfshirjen e studentëve të parë të rregullt ndërkombëtarë, duke rritur perspektivën globale të komunitetit tonë akademik. Programi, gjithashtu, ofron ligjërata nga profesorë nga universitetet prestigjioze



ndërkombëtare, si dhe mundësi të shumta për trajnimin e juristëve të ardhshëm. Gjatë tryezës studentët patën mundësinë të angazhohen në

bisedë me Austin dhe Power. Ata u thelluan në aspekte të ndryshme të jurisprudencës së GJEDNJ-së, duke u thelluar në fushëveprimin dhe ndikimin e Këshillit të Evropës. Bashkëpunimi i ekspertëve dhe profesorëve në reformat e kurrikulës, duke përfshirë zhvillimin e një programi të avancuar në gjuhën angleze, duke u fokusuar në të drejtat e njeriut, të drejtën penale ndërkombëtare dhe drejtësinë tranzicionale, u theksua nga rektori Qerim Qerimi.

Ndalohe punimet në një rrugë afër varrezave ortodokse në Mitrovicën e Veriut

MITROVICË, 25 TETOR - Inspeksioni i komunës së Mitrovicës së Veriut i ka ndërprerë punimet ndërtimore në një rrugë që çon në lagjen shumetnike, Mikronaselje, pasi një grup qytetarësh nga komuniteti serb u ankua se varrezat e vjetra ortodokse u gërmuan gjatë punimeve.

Zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, tha të mërkurën për "Radion Evropa e Lirë" se rasti është duke u hetuar.

Policia e rrethoi zonën me shirit bardhekuq, që do të thotë se punimet e mëtejshme janë ndaluar.

Kryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq, tha për "REL"-in se ka qenë "gabim teknik i kompanisë që ka fituar tenderin nga Ministria e Infrastrukturës" dhe se ende nuk ka informacione të hollësishme. Ai tregoi se ndërtimi i rrugës nuk është projekt i komunës. "Ajo që dimë është se ata gërmuan varrezat ortodokse dhe drejtori ynë i inspektimit e ndaloi punën. Ne presim informacion më të hollësishëm për të parë se si mund të rregullojmë gjithçka", tha ai.

Disa medie lokale që raportojnë në gjuhën serbe kanë thënë se rruga është duke u ndërtuar si



pjesë e një projekti për ndërtimin e shtëpive për të kthyerit nga komuniteti shqiptar, i financuar nga Qeveria e Kosovës.

"REL"-i i drejtua Qeverisë së Kosovës për këtë rast, por nuk mori përgjigje.

Qytetarët ngrenë padi

Një grup prej rreth 20 banorësh të Mitrovicës Veriore nga radhët e komunitetit serb kanë bërë kallëzim penal për gërmimin e

një varreze. Një prej tyre është edhe Nikolla Kabashiq, i cili në një deklaratë për gazetarët tha se policia i ka thënë se për momentin nuk e di nëse bëhet fjalë për ndërtim pa leje për të cilin është përgjegjës komuna

apo për ndonjë vepër penale. "Prandaj, kemi ardhur të themi se 'përdhosja e varreve apo kufomave' është ende vepër penale dhe se dënohet me ligj", tha Kabasic, ish-gjyqtar i cili u largua nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar pas vendimit të Qeverisë së Kosovës.

Kabasic tha se pas hetimeve policore, ai pret që prokuroria të nisë një hetim kundër klientit dhe kontraktorit. "Varrezat janë të shënuara qartë. Ka më shumë se 30 gurë varresh. Ato janë disa qindra vjet të vjetra. Kjo nuk është një çështje politike, kjo është një çështje ligjore, një çështje civilizimi", tha Kabasic.

Varrezat e reja ortodokse të qytetit të Mitrovicës Veriore gjenden në Rudarë afër Zveçanit prej vitit 1999.

Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës në Kosovë, ka reaguar ndaj gërmimit të varrezave të vjetra. Siç thuhet në njoftim, gërmimi i varrezave ortodokse në veri të Mitrovicës "bëhet nga kompanitë shqiptare me urdhër të qeverisë së Albin Kurtit". Ata kërkojnë nga bashkësia ndërkombëtare ta ndalojë "përdhosjen e varreve serbe".

Në kufi me Serbinë sekuestrohen 182 kg marijuanë në vlerë rreth 400 mijë euro

PRISHTINË, 25 TETOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se si rezultat i bashkërendimit të aktiviteteve të drejtorive policore, ka realizuar me sukses një ndërhyrje operative-hetimore e cila ka rezultuar me arrestimin e dy të dyshuarve si dhe kapjen e një sasive të konsiderueshme të substancës së dyshuar narkotike të llojit marijuanë. "Me datën 24.10.2023 rreth orës 21:35, pas informacioneve të shkëmbyera nga Njësia e Task Forcës e Policisë Kufitare - Lindje me Drejtorinë për Hetimin e Trafikimit me

Narkotikë në zonën kufitare RKS/SRB është ndaluar vetura e dyshuar me targa vendore e cila pas kontrollimit nga njësitë policore tek e njëjta është gjetur sasi e dyshuar e narkotikëve të llojit marihuanë e cila dyshohet se ishte duke u transportuar nga Serbia për në Republikën e Kosovës", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Lidhur me rastin janë ndërmarrë menjëherë veprime hetimore. Në konsultim me prokurorin kujdestar janë arrestuar dy të dyshuar shtetas të Kosovës, Y. H. (1998) dhe D. H. (1990), për

transportim të narkotikëve si dhe janë sekuestruar narkotikë në sasi prej 182 kilogramësh të llojit marijuanë. Vlera e kësaj substance narkotike në treg dyshohet të jetë rreth 400 000 euro. "Si prova materiale relevante për rastin janë sekuestruar një veturë dhe një kombi me targa vendore të cilat janë përdorur në rast si dhe dy telefona celularë. Të dyshuarit pas intervistimit me vendim të prokurorit dërgohen në ndalim policor prej 48 orësh, ndërsa rasti i iniciuar 'Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e



paautorizuar e sub. narkotike - Neni 267 të KPRK-së' procedohet tek njësitë

kompetente për trajtim të mëtejshëm", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Deputeti nga Estonia kërkon nga Kosova dhe Serbia të punojnë për shpërshkallëzimin e situatës në veri

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 TETOR - Kryetari i Grupit të Miqësisë me Kosovën në Parlamentin e Estonisë, deputeti Kristo Enn Vaga, ka thënë se shteti i tij po përcjell me vëmendje situatën e sigurisë në Kosovë. Nga Prishtina ai u ka bërë thirrje të dy shteteve që të punojnë për shpërshkallëzimin e situatës. Madje ka garantuar mbështetjen e shtetit të tij në çdo hap për Kosovën.

Vaga pohoi se do të punojë me vendet anëtare që të gjendet paqe në rajon. "Diskutua për situatën në Kosovë. Parlamenti i Estonisë me vëmendje e ka përcjellë situatën. Kosova po punon, por edhe duhet të punojë për shpërshkallëzimin e situatës. I bëjmë thirrje Serbisë të punojë për shpërshkallëzimin e situatës që të gjendet një zgjidhje", ka thënë Vaga.

Fitore Pacolli, kryetare e Grupit të Miqësisë Kosovë - Estoni, ka bërë me dije se në këtë takim

është përmendur bashkëpunimi në fushën e digjitalizimit dhe investimeve. Deputetja Pacolli ka thënë se në këtë takim është diskutuar edhe për sulmin e 24 shtatorit në veri të Kosovës ku, sipas saj, Kosova e ka mbështetjen e plotë të shtetit të Estonisë. "Gjatë dy viteve të fundit ka pasur shkëmbime të shpeshta ndaj dy shteteve. Interesi mes dy shteteve është shumë i madh që ta vazhdojmë bashkëpunimin tutje dhe të bashkëpunojmë në fushat e digjitalizimit. U përmend sulmi terrorist i cili u organizua më 24 shtator. Këtu kemi mbështetjen e fortë të Estonisë sa i përket luftës sonë për demokraci dhe për paqen në rajon. Po ashtu, sa i përket edhe të drejtës së Kosovës për të marrë pjesë në organizata ndërkombëtare si shtet me të drejta të plota, për të mos u bllokuar nga Serbia. Gjithashtu, mbështetje e rezervë Estonisë për anëtarësim në Këshillin e Evropës, sidomos në BE", ka thënë deputetja Pacolli.



Përmbaruesi privat, i shkarkuar nga Ministria e Drejtësisë, ankohet në Kushtetuese



PRISHTINË, 25 TETOR - Shoqëria e Avokatëve "DeJure Law Firm" të mërkurën ka dorëzuar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese në emër të Ilir Mulhaxhës, i cili është shkarkuar nga detyra e përmbaruesit nga Ministria e Drejtësisë për mospërbajtje të ligjit gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore.

Përfaqësuesi i "DeJure Law Firm", avokati Yll Zekaj, tha se shkarkimi i përmbaruesit Mulhaxha ishte vendim politik dhe jo ligjor. Sipas tij, i shkarkuari tashmë ka zbatuar një vendim të plotfuqishëm të Gjykatës Kushtetuese.

Më tutje, Zekaj tha se kërkesa e tyre është kundër vendimit të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa shtoi se në një afat kohor do të vërtetohen argumentet e drejtuara në kërkesë për kthimin e Mulhaxhës në pozitën e përmbaruesit. Në janar të këtij viti ministrja e

Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka njoftuar se në kuadër të kompetencave ligjore, ka marrë vendim për suspendimin e përmbaruesit privat Ilir Mulhaxha.

Haxhiu në "Facebook" ka shkruar: "Ky vendim është marrë pas kërkesës së AKP-së për inicimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat, mbi bazën e shkeljeve ligjore të pretenduara. Andaj, për t'u siguruar që procedura disiplinore zhvillohet pa pengesa dhe pa asnjë ndikim, kam marrë vendim siç përcaktohet në dispozitiv. Nuk mund të tolerojmë që mbi kurrizin e interesit të përgjithshëm të realizohen interesa të kundërligjshme personale", ka shkruar ministrja.

Përmbaruesi Mulhaxha ishte suspenduar edhe më 06.12.2022 nga po e njëjta ministri.

Rreth 700 kërkesa për lirim me kusht për 9 muaj, 50 për qind e tyre janë aprovuar

PRISHTINË, 25 TETOR - Rreth 700 kërkesa për lirim me kusht janë bërë nga janari deri në shtator të këtij viti. Kështu tha kryesuesja e Panelit për Lirim me Kusht, Valdete Daka, e cila u shpreh se rreth 50 për qind e

kërkesave po aprovohen. Para Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Daka u shpreh se paneli funksionon në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. "Kemi pranuar 681 kërkesa, janë aprovuar 269 kërkesa. 50

për qind të kërkesave aprovohen, që është bukur numër i lartë. Nuk qëndron ajo që asnjë nuk e merr lirin me kusht", tha Daka. Ajo shtoi se duhet të plotësohen disa kriteret për aprovim të kërkesave. (ksp)



Komisioni për Buxhet voton për akcizën për cigaret elektronike dhe duhanin e papërpunuar

PRISHTINË, 25 TETOR - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka votuar për kërkesën e Qeverisë së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të ekzekutivit lidhur me vendosjen e akcizës për cigaret elektronike dhe duhanin e papërpunuar. Për këtë pikë ka raportuar ministri i Financave, Hekuran Murati, i cili ka thënë se ky ndryshim ka qenë i nevojshëm për shkak që

shteti të përfitojë nga mbledhja e akcizës dhe të parandalohet kontrabandimi i produkteve të reja. Xhemajl Fejza, nga Dogana e Kosovës, ka thënë se vendosja e akcizës parashihet të bëhet për duhanin e papërpunuar dhe disa produkte të reja. Fejza ka pohuar se me këtë ndryshim nuk parashihet vendosja e akcizës për duhanin e zakonshëm. Deputeti i PDK-së, Mërgim

Lushtaku, ka thënë se do të duhej të kishte analizë me vendet e rajoni sa i përket vendosje së akcizës së këtyre produkteve. Ai ka kërkuar të rritet akciza për duhanin e zakonshëm në mënyrë që, sipas tij, të stimulohet mospirja e duhanit. Edhe deputeti i LV-së, Eman Rrahmani, ka thënë se do të duhej të rritej akciza e duhanit pasi në këtë mënyrë, sipas tij, do të ulej përdorimi i saj.



Kryetari i BSPK-së: Agjendën e Gjellbër ta harmonizojmë me parimet e drejtësisë sociale

PRISHTINË, 25 TETOR - Në Selanik të Greqisë më 19 dhe 20 tetor Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (KESE) ka organizuar Forumin e 9-të të Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor.

Forum i 9-të i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor mbledhi së bashku rreth 120 pjesëmarrës, përfshirë një gamë të gjerë përfaqësuesish të shoqërisë civile nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor, si dhe përfaqësues të institucioneve të BE-së, të organizatave ndërkombëtare dhe të qeverive të rajonit.

Në këtë ngjarje mori pjesë edhe kryetari i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Atdhe Hykollit, i cili ishte një ndër panelistët në panelin "Kontributi i shoqërisë civile në implementimin e Agjendës së Gjellbër dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Evropës Juglindore".

Në panelet e tjera u diskutua edhe gjendja e demokracisë në Evropën Juglindore: "testi i gjendjes" së shoqërisë civile në rrugën drejt zgjerimit të BE-së; Viti Evropian i Aftësive 2023 - Zhvillimi i aftësive gjatë gjithë jetës në Evropën Juglindore përmes Arsimit dhe Formimit Profesional fillestar dhe të vazhdueshëm (I-AFP/V-AFP); Garancia për arsimin, aftësitë dhe rininë në Ballkanin Perëndimor; si dhe Formimi i vazhdueshëm profesional, përmirësimi i aftësive dhe riaftësimi në Ballkanin Perëndimor".

Kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykollit,



ngriti çështjen e Agjendës së Gjellbër, duke e vënë theksin e saj në qëndrueshmërinë mjedisore dhe mirëqenien e komuniteteve tona, të kornizës kritike për rajonin tonë në shekullin e 21-të. Po ashtu, vuri në pah se Agjenda e Gjellbër është më shumë se thjesht një angazhim për mbrojtjen e mjedisit, po është një angazhim për të ardhmen tonë të përbashkët, për një botë që është e banueshme dhe e begatë për

brezat që do të vijnë.

Hykollit vuri në pah se organizatat e shoqërisë civile si dhe BSPK-ja kanë një rol vendimtar për të luajtur në formësimin e politikave dhe praktikave që do të na çojnë drejt një të ardhme më të gjellbër dhe më të qëndrueshme. Ai, po ashtu, theksoi se BSPK-ja vepron si një urë lidhëse, duke lidhur institucionet qeveritare, sektorin privat dhe publikun e gjerë, duke siguruar që Agjenda e

Gjellbër të mos jetë thjesht një grup fjalësh në letër, por një plan gjithëpërfshirës dhe efektiv për veprim.

Hykollit ua përkujtoi të pranishmëve se "kalimi në një ekonomi të gjellbër dhe të qëndrueshme nuk duhet të bëhet në kurriz të të drejtave të punëtorëve dhe të standardeve të jetesës. Është e domosdoshme që ne ta harmonizojmë Agjendën e Gjellbër me parimet e drejtësisë

sociale dhe të gjithëpërfshirjes. Ne duhet të avokojmë për politika që sigurojnë një tranzicion të drejtë për punëtorët në industritë që mund të preken nga ndryshimet mjedisore. Kjo përfshin programe riaftësimi dhe rikualifikimi për të ofruar mundësi për punëtorët në sektorët në zhvillim".

Në fund të Forumit të 9-të u miratua një deklaratë përfundimtare me rekomandime nga organizatat e shoqërisë civile.

Hapet Panairi i Produkteve Bujqësore

PRISHTINË, 25 TETOR - Oda Ekonomike e Kosovës, në bashkëpunim me komunën e Prishtinës, kanë hapur Panairin e Produkteve Bujqësore dhe Agroindustriale "Prishtina 2023". Në këtë organizim u vu në theks rëndësia e promovimit të produkteve vendore derisa u bë thirrje për mbështetjen e tyre.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka

thënë se ky panair ka rëndësi jo vetëm për vendin, por edhe për rajonin meqë, sipas tij, ka rëndësi ekonomike, strategjike dhe sociale, kështu duke përmirësuar imazhin e Kosovës. Ai ka thënë se ky panair do ta shndërrojë Prishtinën në një qytet të rajonit, kurse ka shprehur gëzim për bashkëpunimin me komunën e Prishtinës dhe USAID-in për të mundësuar

një organizim të tillë.

Nënkryetari i kryeqytetit, Alban Zogaj, ka thënë se ky panair do të sjellë atmosferë në Prishtinë, derisa ka shtuar se do të jetë një shesh i talentit tonë të krijimit dhe pasionit të prodhimeve vendore. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve ta vizitojnë panairin, duke potencuar se "çdo blerje e prodhimit vendor është fuqizim i ekonomisë vendore". (kp)



Baba i bashkimit kombëtar apo i asociacionit



Shkruan: Bekim ÇOLLAKU

Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje u ngjiten në skenën politike të Kosovës me premtimin për një qeverisje transparente, demokratike dhe të ndershme. Kurti iu premtoi votuesve të tij se nuk do të negociojë me Serbinë, së paku jo pa kërkuar Serbia falje për të gjitha krimet e bëra në Kosovë. Sloganet e tyre ishin të fuqishme, duke u bërë thirrje për ndryshim dhe duke sfiduar status quo-në. Megjithatë, ardhja e tyre në pushtet solli me vete edhe një ndryshim në qasjen politike, veçanërisht në lidhje me çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe apo "Zajednicën", siç preferonte ta quante z. Kurti. Negocimi dhe pranimi i Marrëveshjes Bazike nga ana e Kurtit, e cila në themel të saj e ka themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, është dëshmi e qartë se si ai ka ndryshuar qëndrimin e tij politik, duke i tradhtuar kështu qytetarët që e votuan. Kurti ka qenë një kundërshtar i ashpër i Asociacionit, duke e konsideruar atë si një kërcënim për sovranitetin e Kosovës. Ai ka argumentuar se ky lloj Asociacioni është një produkt i ndikimit serb dhe atij ndërkombëtar, dhe se ai do të minonte pavarësinë dhe integritetin territorial të Kosovës. Megjithatë, pas ardhjes në pushtet,

qëndrimi i Kurtit ka ndryshuar ndjeshëm. Ai e ka pranuar Asociacionin, duke e bërë këtë pjesë të bisedimeve të brendshme dhe ndërkombëtare. Dhe, si rrjedhojë, Kurti do të detyrohet që ta themelojë këtë Asociacion! Ky ndryshim i qëndrimit, sigurisht ka shkaktuar zhgënjim të madh mes elektoratit të Kurtit dhe ka ngritur pyetje të rëndësishme mbi integritetin e tij politik. A është ky një rast i thjeshtë i realpolitikës, ku Kurti duhet të bëjë kompromise për të arritur qëllime më të mëdha? Apo është një shembull flagrant i mashtrimit politik, ku premtimet elektorale janë hedhur poshtë, në emër të interesave personale ose të ngushta politike? Apo, ndoshta mund të argumentohet se ky ndryshim i qëndrimit të Kurtit është reflektim i realitetit të ashpër të politikës dhe nevojës për kompromise. Megjithatë, kjo nuk e justifikon aspak mënyrën se si ai e transmeton këtë ndryshim përballë opinionit publik. Gjatë tërë kohës ka pasur një mungesë të qartë transparence dhe ndershmërie në mënyrën se si Kurti dhe ekipi i tij e kanë menaxhuar këtë çështje, duke lënë shumë qytetarë të ndihen të tradhtuar dhe mashtruar. Integriteti politik kërkon që liderët të jenë të ndershëm dhe

transparentë me zgjedhësit e tyre. Kur premtimet elektorale bëhen vetëm mjete për të arritur në pushtet, dhe jo udhërrëfyes për veprimin politik, demokracia vihet në rrezik. Kurti ka detyrimin të shpjegojë ndryshimin e qëndrimit të tij dhe të demonstrojë se si kjo i shërben interesave të Kosovës, dhe jo vetëm interesave të ngushta politike.

Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje erdhën në pushtet me premtimin për një ndryshim të madh politik dhe shoqëror në Kosovë. Megjithatë, ndryshimi i tyre i qëndrimit në lidhje me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe ka shkaktuar zhgënjim të madh dhe ka hedhur dyshime mbi integritetin e tyre politik. Kurti duhet të tregoj se ky ndryshim qëndrimi është në të mirën e Kosovës, në të kundërtën, duhet të kërkojë falje publike ndaj atyre që i ka fyer dhe akuzuar për tradhti për vite të tëra. Kurti duhet ta pranojë publikisht që kundërshtimi i Asociacionit kur ishte në opozitë, ka qenë thjesht një veprim strategjik për të fituar vota, e jo një kundërshtim parimor. Ai duhet të sqarojë se asociacioni në fjalë nuk ka qenë kërcënim për sovranitetin e Kosovës as në vitin 2013, dhe nuk është as sot, në vitin 2023. Kurti, duhet të rrëfëhet publikisht në rast

se pretendon se ende nuk është zhveshur nga të gjitha parimet që i kishte proklamuar përpara ardhjes në pushtet. Demokracia dhe integriteti politik nuk kërkojnë asgjë më pak se kaq.

Albin Kurti ka investuar gjithë karrierën e tij vetëm e vetëm që të zërë një vend në historinë moderne të Kosovës. Ai ka shfaqur ambicie edhe më të mëdha. Së pari, ai ka synuar të zërë vend në historinë kombëtare shqiptare, prandaj në thelb të platformës së tij dikur (para ardhjes në pushtet) ishte slogani për bashkim kombëtar. Së dyti, Asociacioni apo "Zajednica" ka qenë ajo çfarë Albini publikisht e ka kundërshtuar me të gjitha mjetet. Votuesit i kanë besuar Albinit plotësisht në përmbyshjen e këtyre do qëllimeve politike.

Mandati i Albin Kurtit si kryeministër i Kosovës po shkon drejt fundit. Kurti tashmë ka hequr dorë nga bashkimi kombëtar dhe ka ulur nivelin e bashkëpunimit politik ndërshtetëror ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë në nivelin më të ulët që nga përfundimi i luftës në vitin 1999. Në anën tjetër, Kurti e ka pranuar Marrëveshjen Bazike, e cila në thelb e ka themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Prandaj, hapi i radhës për Kurtin pashmangshëm është themelimi i

këtij asociacioni. Sipas kësaj perspektive transformuese, Kurti është në prag të dhënies vulë të trashëgimisë së tij politike. Ende nuk është e qartë se çfarë vendi do të zërë ky transformim i tij radikal në historinë tonë moderne.

Sido që të jetë, janë vetëm qytetarët e Kosovës ata që duhet të gjykojnë dhe ta mbajnë përgjegjës Albin Kurtin dhe trashëgiminë e tij politike. Faktori kohë shumë shpejt do të dëshmojë se çfarë trashëgimie politike do të lerë mbrapa ai. Për votuesit e tij do të ishte fatkeqësi e madhe që Albin Kurti nga premisa e tij për t'u bërë një nga baballarët e bashkimit kombëtar, të përfundojë si themelues i "Zajedncës." Në rast se kjo hipotezë vërtetohet nga veprimet e Kurtit, atëherë jo vetëm historia do të tregohet e pamëshirshme, por krahas saj edhe votuesit e tij. Kurti e di ose do të duhej ta di në një gjë të tillë.

Si përfundim, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka për detyrë të mendojë jo vetëm për fatin e tij personal politik po, mbi të gjitha, duhet ta verë në rënd të parë interesin e shtetit të Kosovës. Ata udhëheqës, të cilët deri më sot e kanë vënë interesin e Kosovës mbi gjithçka tjetër, kanë zënë vendin e merituar në historinë tonë moderne. Kurse për ata të tjerët... askund. Asgjë!

Kryqëzimi i Jezu Krishtit: Kush ishin aktorët kryesorë



Praktikisht, historia e kryqëzimit të Jezus Krishtit fillon në momentin kur ai u tradhëtua. Që nga ky moment, deri në vdekjen e tij, ishin disa persona që u përfshinë në fazat e fundit të jetës së Jezusit. Zbulojmë cilët ishin dhe rolin që duhej të luanin.

Judë Iskarioti

Para se të tradhëtohej nga Juda, Jezusi ishte tashmë një njeri i kërkuar. Ai kishte zemëruar farisenjtë, herodianët dhe saducenjtë me predikimet e tij. Dhe e mbushi kupën kur sulmoi tempujt dhe akuzoi udhëheqësit se e kishin kthyer shtëpinë e Atit të tij në treg. Arrestimi ishte i pashmangshëm. Juda zbuloi vendndodhjen e Jezusit për tridhjetë copa argjendi. Më vonë, Juda e ktheu mbrapsht argjendin dhe u vetëvar prej turpit.

Kajafa

Para se të shkonte tek Ponc Pilati, Jezusi u gjykua nga Kajafa. Përfshirja e Kryepriut në kryqëzimin e Krishtit është domethënëse. Jezusi përbënte një kërcënim për pushtetin e Kajafës, ndaj duhej të ndalohej

me çdo kusht. Jezusi u gjykua padrejtësisht në një gjyq të montuar, që u zhvillua në shtëpinë e Kajafës gjatë natës, ku Kryepriuti mori në mënyrë të paligjshme rolin e prokurorit dhe gjykatësit. Jezusi u akuzua për blasfemi dhe u dënua me vdekje. Për ekzekutimin, Kajafa kërkoi ndihmën e autoriteteve romake.

Ponc Pilati

Romakët e pushtuan Palestinën në vitin 63 para Krishtit, ndaj ishin ata në pushtet gjatë kohës së Jezusit.

Ponc Pilati ishte guvernator i Judesë. Atij pak i bëhej vonë për Jezu Krishtin, veç faktit që ai kërcënonte paqen. Pra, kur Kajafa ia paraqiti Jezusit Pilatit, akuzat ishin për rebelim dhe jo blasfemi.

Akuza e Blasfemisë do të kishte qenë disi e pakuptimtë për Pilatin. Sido që të jetë, Pilati e

shpalli Jezusin të pafajshëm. Por nuk mbaroi me kaq.

Turma (1)

Vendimi i Pilatit nuk i pëlqeu turmës, e bindur se Jezusi ishte fajtor. Pilati, ndonëse besonte se Jezusi nuk kishte bërë asgjë të keqe, nuk donte të kishte telashe me një turmë agresive, veçanërisht gjatë festës së Pashkës.

Ai ushtroi publikisht traditën e lirimit të një të burgosuri për Pashkë, ndoshta me shpresën se turmat do të lironin Jezusin, dhe do të ndëshkonin një person që tashmë kishte nam si kriminel...

Turma (2)

Baraba, një i burgosur famëkeq, u vendos përkrah Jezusit dhe turma u ftua të lironin njërin nga të dy. Në vend që të zgjidhte lirinë e Jezusit, turma zgjodhi Barabën, duke mos i lënë Pilatit zgjidhje tjetër, përveçse ta dënonte Jezusin me vdekje, përpara se të lante në mënyrë simbolike duart nga e gjithë kjo çështje.

Simoni i Kirenës

Jezusin e rrahën dhe e çuan në Golgotë për ta kryqëzuar. Kryqi mbi të cilin ai u dënua të vdiste u

mbajt prapa Jezusit, nga një person që Bibla e quan Simoni nga Kirena. Tre nga katër ungjijtë përmendin Simonin me emër.

Sipas një përkthimi të Ungjillit sipas Lukës, 'ata e detyruan Simonin, një burrë nga Kirena, i cili rastësisht po vinte nga fshati, të mbante kryqin pas Jezusit'.

Deri këtu është i vetmi personazh që, të paktën për një kohë të shkurtër, ia lehtësoi vuajtjet Krishtit.

Maria Magdalena

Edhe Maria Magdalena u shfaq si një qetësuese, në mes të gjithë këtij tmerr. Sipas Biblës, Jezusi e kishte shëruar Maria Magdalenën nga shtatë 'demonë' dhe të gjithë ungjijtë (përveç Lukës) thonë se ajo ishte dëshmitare e kryqëzimit të Jezusit dhe varrosjes së tij. Edhe më e rëndësishmja, pikërisht Marisë iu shfaq Jezusi për herë të parë pas vdekjes.

Maritë

Shkruhet nga Shën Gjoni se nëna e Jezusit, Maria, ishte gjithashtu dëshmitare e kryqëzimit, por më pas, ka pak konfuzion. Sipas ungjijve, mund të ketë qenë deri në katër Mari të pranishme. Shën Gjoni thotë se nëna e Jezusit, Maria e Magdalës dhe Maria, gruaja e Klopës (e cila ndoshta

ishite teza e Jezusit) ishin të pranishme.


Shën Mateu dhe Shën Marku pohojnë se një tjetër Mari, nëna e Jakobit dhe/ose Jozefit, ishte gjithashtu dëshmitare e kryqëzimit.

Longinus

Longinus ishte emri biblik i ushtarit anonim, i cituar nga Shën Gjoni, i cili shpoi ijen e Jezusit me shtizë. Emri i tij rrjedh nga fjala greke për "majë shtize", sepse dihet shumë pak për të. Një Centurion romak anonim shfaqet gjithashtu në ungjijtë sipas Markut dhe Lukës, dhe në këtë version, ushtari shpalli besimin e tij se njeriu i kryqëzuar ishte me të vërtetë Biri i Perëndisë.

Shën Dismas dhe Gestus

Të gjithë ungjijtë përmendin dy kriminelë të kryqëzuar përkrah Jezusit. Më vonë atyre iu dhanë emrat Dismas, hajduti i penduar dhe Gestus, hajduti i papenduar. Shën Marku tregon se si Jezusi u fye nga priftërinjtë dhe turma. Shën Luka shkroi se një nga hajdutët (me sa duket Gestus) u bashkua me talljen dhe u qortua nga Dismas, i cili më pas i kërkoi Jezusit ta kujtonte atë. Jezusi u përgjigj duke i thënë hajdutit të penduar se i është dhënë vendi në parajsë. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Akil Gjakova, i argjendtë në Grand Slamin e Abu Dhabit

ABU DHABI, 25 TETOR - Akil Gjakova e ka fituar medaljen e argjendtë në Grand Slamin e Abu Dhabit. Akili është mposhtur në finale nga garuesi nga Uzbekistani, Shakhram Ahadov, në kategorinë deri në 73 kilogramë.

Deri te medalja Gjakova ka

ardhur pasi në xhiron e parë e ka mposhtur garuesin nga Bahamas, Andrew Munnings. Në xhiron e dytë Gjakova ka mposhtur finlandezin Valtteri Olin, ndërsa në të tretin ishte më i mirë se kazaku Smagulov. Në çerekfinale ai ka eliminuar amerikanin Jack Yonezuka,

ndërsa në gjysmëfinale kazakun Shamshayev. Të mërkurën ka garuar edhe Loriana Kuka në kategorinë deri në 70 kilogramë, por aventura e saj nuk shkoi mirë. Garuesja nga Kosova është mposhtur me Ippon në rrethin e dytë nga austriakja Michaela

Polleres në "Golden Score". Kuka paraprakisht e kishte kaluar rrethin e parë pasi e kishte mundur garuesen holandeze Sanne Vermeer. Sot (e enjte) do të garojë edhe xhudisti tjetër Shpati Zekaj, në kategorinë deri në 100 kilogramë.



Konjufca takohet me Dukën: Kombëtarja e Shqipërisë na ka bërë krenarë të gjithëve



PRISHTINË, 25 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF), njëherësh zëvendëspresident i UEFA-s, Armand Duka, i cili është duke qëndruar për vizitë në Kosovë. Duke i dëshiruar mirëseardhje në Kuvendin e Kosovës si dhe duke e uruar për zgjedhjen zëvendëspresident të UEFA-s, kryetari Konjufca ka përgëzuar kreun e FShF-së për arritjet e

deritashme të kombëtares së Shqipërisë në futboll, sidomos për sukseset e mëdha në garat e fundit për "Euro 2024". "Kombëtarja shqiptare e futbollit është modeli më i suksesshëm i asaj se çfarë mund të arrijmë kur jemi të bashkuar në forca, ide dhe qëllime. Ajo na ka bërë të gjithëve krenarë", ka thënë Konjufca.

Ndërsa kryetari i FShF-së, Armand Duka, ka falënderuar kryetarin Konjufca për pritjen e ngrohtë e miqësore si dhe për diskutimin e hapur lidhur me zhvillimin e sportit

në Kosovë dhe Shqipëri. Në takim është diskutuar edhe për zhvillimin dhe sukseset e futbollit në Kosovë, mbështetjen që Qeveria e Kosovës i jep futbollit, duke u ndalur edhe te bashkëpunimet e mëtejshme në projekte dhe politika konkrete mes dy federatave. Gjatë vizitës kryetari i FShF-së, Armand Duka, shoqërohej nga kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi dhe bashkëpunëtorë të tjerë.

FFK-ja shpërndan policat e sigurimit shëndetësor për klubet e Superligës, Ligës së Parë dhe Ligës U17 të vajzave

PRISHTINË, 25 TETOR - Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) të mërkurën ka bërë shpërndarjen e policës së sigurimit për klubet e Superligës, Ligës së Parë dhe Ligës U17 të vajzave. Shpërndarja është realizuar në selinë e FFK-së, ku ishin të pranishëm nënkryetari Agim Dibrani, anëtarja e Komitetit Ekzekutiv, Vjollca Krasniqi, si dhe drejtori i përgjithshëm i "Sigal"-it, Përparim Drini.

Anëtarja e Komitetit Ekzekutiv, Vjollca Krasniqi, ka falënderuar kompaninë "Sigal" për interesimin që kanë shprehur për bashkëpunimin që prej vitit të kaluar, veçanërisht në sektorin e

futbollit të vajzave. Ajo është shprehur e kënaqur për mbështetjen që po i jepet futbollit të vajzave. Krasniqi ka theksuar se futbollit të vajzave ka nevojë për më shumë mbështetje nga bizneset, por kjo, sipas saj, arrihet përmes rritjes së cilësisë së futbollit.

Ndërsa drejtori i përgjithshëm i "Sigal"-it, Përparim Drini, ka falënderuar FFK-në për bashkëpunimin në dy vitet e fundit. Drini ka theksuar se kanë mbajtur takime me FFK-në për të parë nëse klubet kishin ndonjë pakënaqësi vitin e kaluar, në mënyrë që të sigurohen që gjithçka të shkonte mirë këtë vit. Po ashtu, ai është

shprehur i kënaqur që kompania "Sigal" është sponsor kryesor i Superligës së Vajzave.

Ndërsa drejtoresha e Departamentit të Shëndetit në "Sigal", Arbresha Jonuzi, ka informuar përfaqësuesit e klubeve rreth policës së re. Ajo ka bërë me dije se kontratat janë të njëjta, ashtu sikurse edhe mbulueshmëria. Kontrata aktuale është e vlefshme deri më 30 shtator dhe nga 1 tetori fillon viti i ri. Përfaqësuesit e klubeve kanë shprehur mirënjohje dhe të lumtur për këtë projekt, duke e vlerësuar atë si të suksesshëm dhe të rëndësishëm për ecurinë e klubeve.



Shpaloset projekti i ri i arenës 'Zahir Pajaziti', mbulojë e stadiumit dhe rritje e kapacitetit të ulëseve



PODUJEVË, 25 TETOR - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, së bashku me drejtorin e Sportit, Pajtim Balaj, i kanë pritur të mërkurën në takim drejtuesit e Klubit të Futbollit Llapi, të udhëhequr nga trajneri Tahir Batatina, drejtori sportiv Mentor Zhdrella, sekretari Muhamet Rexhepi dhe disa

futbollistë të prirë nga kapiteni Benjamin Emini. Me këtë rast, Bulliqi ka përgëzuar drejtuesit dhe futbollistët e klubit për paraqitjet dhe ndeshjet e mira që i kanë zhvilluar në këtë fillim kampionati. Ndërsa KF Llapi ka njoftuar se qëllim i takimit me Bulliqin ka qenë shpalosja e projektit të ri të arenës

"Zahir Pajaziti", ku parashihet vendosja e mbulojës së stadiumit, rritja e kapacitetit të ulëseve dhe ndërtimi i tribunës lindore. Në këtë kontekst, kryetari Bulliqi është zotuar se së bashku me Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport do ta mbështetin që arena "Zahir Pajaziti" të marrë pamje edhe më të

bukur. "U zotova para tyre që si komunë do ta mbështetim këtë projekt dhe do të kërkojmë edhe nga Ministria e Sportit mbështetjen e këtij projekti, që kap vlerën e një milion eurove. Arena 'Zahir Pajaziti' do të marrë pamje të mrekullueshme pas investimit", ka njoftuar Bulliqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 27.3 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2023 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 1919 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Auditor junior për auditim të performancës
Numri i referencës:	AJAP/ZKA/17-10/23
Grada:	ZKA-A8
Numri i pozitave:	Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe raporton Drejtorit të Departamentit të Auditimit dhe udhëheqësit të ekipit të auditimit;
- Kryen hulumtime dhe analizë për fushën të caktuar dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së; (nën mbikëqyrje nga UA);
- Pjesëmarrje aktive në parastudim të auditimit në fusha të caktuara dhe deleguara nga UE;
- Ofron përkrahje profesionale duke kryer hulumtime dhe analiza të dhënave të mbledhura dhe prezantimin e tyre;
- Mbajtja e shënimeve dhe dokumentimi i intervistimit dhe gjetjeve tjera;
- Nxjerrja konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve duke u mbështetur në dëshmitë audituese dhe në bazë të gjykitimit profesional;
- Përgatitja e Letrave të punës me kohë së bashku me dëshmitë përkatëse dhe memo përmbledhës lidhur me auditimin e komponentës, fushës apo pyetjeve audituese, e cila i është caktuar;
- Indeksimi i letrave të punës dhe diskutimi me Udhëheqësin e tij/saj;
- Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
- Aplikimi i punës online sipas kërkesave dhe udhëzimeve në nivel të zyrës për situata të caktuara;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale të kërkuara nga UEA dhe nga Drejtori i departamentit.

Kualifikimet Themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në hulumtim apo analiza, preferohet përvojë në auditim;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathësi në organizim të punës dhe përbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **10.11.2023 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa Članom 15.2 Zakona Br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i Članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj kancelariji revizije (izmenjeno i dopunjeno Pravilnikom (NKR) Br. 01/2023), vezano za Član 27.3 Pravilnika (NKR) 02/2021 za kvalifikaciju radnih mesta, godišnjeg plana zapošljavanja za 2023. godinu, kao i Odluci Generalne revizorke sa Br. 1919 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnih radnih mesta

1. Pozicija:	Junior Revizor za reviziju učinka
Broj reference:	AJAP/ZKA/17-10/23
Koeficijent:	NKR-A8
Broj pozicija:	Dva (2)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Vrši revizije u skladu sa godišnjim planom, pravilima i metodologijom NKR-a, Etičkim kodeksom i u skladu sa Međunarodnim standardima revizije i izveštava direktoru Sektora za reviziju i vodi revizorskog tima;
- Vrši istraživanje i analizu za zadatu oblast i predlaže teme revizije za strateško i godišnje planiranje NKR-a (pod nadzorom AU);
- Aktivno učešće u pred-studijama revizije u određenim oblastima koje je delegirala VT;
- Pružna stručnu podršku kroz istraživanje i analizu prikupljenih podataka i njihovu prezentaciju;
- Vođenje beleški i dokumentovanje intervjuja i drugih nalaza;
- Donošenje zaključaka i davanje preporuka na osnovu revizorskih dokaza i na osnovu profesionalnog prosuđivanja;
- Priprema radnih dokumenata na vreme zajedno sa relevantnim dokazima i rezimeom memoranduma koji se odnosi na reviziju komponente, polja ili pitanja revizije koja je određena;
- Indeksiranje radnih dokumenata i razgovor sa njegovim/njenim vođom;
- Kontinuirano izveštavanje supervizora o napretku postignutom u reviziji;
- Primena onlajn rada prema zahtevima i uputstvima na nivou kancelarije za određene situacije;
- Obavlja i druge stručne poslove na zahtev VRT i direktora odeljenja.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u istraživanju ili analizi, poželjno je iskustvo u reviziji;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Potrebne veštine:

- Poznavanje polja revizije;
- Veštine u organizaciji rada i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji važe za Nacionalnu kancelariju revizije;
- Poznavanje o efektivnom nadzoru profesionalnog rada;
- Veštine da predstavlja i štiti interese institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikativne veštine u timu;
- Dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene pozicije vrši se u skladu sa zakonom na snazi.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za apliciranje;
- kopiju lične karte Republike Kosova;
- dokaze o školskoj spremi (diploma fakulteta), Diplome stečene van Kosova moraju biti itnostrifikovane;
- dokaze o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu sa priloženim dokazima iz Trusta);
- svedočenje iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije **10.11.2023** godine do **16.00** časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručjenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Ekonomist për Stabilitet Financiar (Zyrtar)
Departamenti: Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar
I raporton: Drejtorit të Departamentit për Analiza Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar
Grada: 6

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Implementon programin afatshkurtër dhe afatmesëm të punës në fushën e stabilitetit financiar;
- Merr pjesë në përgatitjen e analizave të sektorit financiar me qëllim të arritjes së objektivave përkatëse dhe realizimit të detyrave përkatëse të BQK-së;
- Analizon dinamikat e tregjeve dhe institucioneve financiare, me qëllim të identifikimit të rreziqeve që përbëjnë kërcënime për stabilitetin e sistemit financiar;
- Kontribuon në vlerësimin e rrezikut sistematik, përmes analizimit dhe avancimit të vazhdueshëm të instrumenteve dhe modeleve për vlerësimin e këtij rreziku;
- Kontribuon në definimin e kërkesave për të dhëna e duhura në procesin e hulumtimit duke përfshirë mbledhjen, përpilimin dhe organizimin e të dhënave statistikore relevante për procesin e hulumtimeve;
- Rekomandon dhe kontribuon në çështje të ndryshme me relevancë për fushën e stabilitetit financiar dhe proceset e punës në departament;
- Mbështetë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante përkitazi me çështjet e stabilitetit financiar;
- Përbush detyra tjera në bazë të kërkesës së mbikëqyrësit.

Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë bachelor në fushën e ekonomisë, financave, bankingut, studimeve kuantitative apo fushë tjetër me përmbajtje të theksuar ekonomike dhe financiare;
- Diploma master e preferueshme;
- Njohuri dhe shkathtësi modelimi; shkathtësi në fushën e ekonometrisë; njohuri mbi teoritë moderne ekonomike dhe financiare;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar dhe njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze.

Përvoja e kërkuar:

- Kërkohej përvojë pune prej së paku 2 vite, në analiza ekonomike dhe financiare, në institucione financiare, institucione kërkimore, bankë qendrore apo subjekte tjera me karakter kërkimor.

Kërkesa të posaçme:

- Aftësi shumë të mira analitike, të shkruara dhe në të folur;
- Vet-iniciativë, aftësi të zgjidhjes së problemeve, bashkërendimit dhe punës në grup.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUSTI) ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **09 nëntor 2023**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.
- Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e shpalljes do të kontaktohen.



OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU

Zvanje: Ekonomista za finansijsku stabilnost (službenik)
Odeljenje: Odeljenje za ekonomske analize i finansijsku stabilnost
Izveštava: Direktora Odeljenja za ekonomske analize i finansijsku stabilnost
Stepen: 6

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Implementira kratkoročni i srednjoročni program rada u oblasti finansijske stabilnosti;
- Učestvuje u pripremi analiza finansijskog sektora u cilju postizanja relevantnih ciljeva i realizacije relevantnih dužnosti CBK-a;
- Analizira dinamike finansijskih tržišta i institucija, kako bi se identifikovali rizici koji predstavljaju pretnju stabilnosti finansijskog sistema;
- Doprinosi u proceni sistematskog rizika, kroz analizu i kontinuirano unapređenje instrumenata i modela za procenu ovog rizika;
- Doprinosi definisanju zahteva za odgovarajućim podacima u procesu istraživanja, uključujući prikupljanje, izradu i organizaciju statističkih podataka relevantnih za proces istraživanja;
- Predlaže i doprinosi različitim pitanjima od značaja za oblast finansijske stabilnosti i procesa rada u odeljenju;
- Podržati neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama u vezi sa pitanjima finansijske stabilnosti;
- Ispunjava i druge dužnosti na zahtev nadzornog.

Potrebna znanja:

- Diploma bachelor iz oblasti ekonomije, finansija, bankarstva, kvantitativnih studija ili druge oblasti sa značajnim ekonomskim i finansijskim sadržajem;
- Poželjna je master diploma;
- Znanje i veština modeliranja; veštine iz oblasti ekonometrije; poznavanje savremenih ekonomskih i finansijskih teorija;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju i odlično znanje engleskog jezika.

Potrebno iskustvo:

- Potrebno je radno iskustvo od najmanje 2 godine, na poslovima ekonomske i finansijske analize, u finansijskim institucijama, istraživačkim institucijama, centralnoj banci ili drugim subjektima istraživačkog karaktera.

Posebni zahtevi:

- Vrlo dobre analitičke, pismene i govorne sposobnosti;
- Samoinicijativnost, sposobnost rešavanja problema, koordinacija i timski rad.

Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono pismo) u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Izveštaj Fonda penzione štednje Kosova (TRUSTI) ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate / nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Procedura apliciranja:

- Krajni rok za apliciranje je **09 novembar 2023**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene web stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće se uzeti u obzir.
- Obrazac apliciranja možete preuzeti preko službene web stranice: www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija neće se uzeti u obzir.
- Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume oglasa.



NJOFTIM PËR KONTRATË

Tenderi
(Shërbim)

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Shtator 2021)"

I Numërtimi i Prokurimit: BQK 23 047 221

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK

II LËNDA E KONTRATËS

II.1.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja: "Shërbime nga shoqëri të avokateve për shërbime të përfaqësimit dhe të konsulences për BQK-në"

III VENDI I REALIZIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Objekti i BQK-së, rr. "Garibaldi" nr. 33, 10000 Prishtinë.

IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 "Tenderi i ekonomikisht më i favorshëm" (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet)

V INFORMATA ADMINISTRATIVE

V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata tjera:

Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 03.11.2023 ora 14:00 në e-mail adresën

prokurimi@bqk-kos.org

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 03.11.2023 ora 14:00

V.2 Vendi dhe afati i fundit për dorëzimin e tenderëve:

Adresa: në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. "Garibaldi" nr. 33, Prishtinë:

Data: 07.11.2023, ora 14:00

V.3 Sigurimi i tenderit: 5,000.00 € (pesë/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite.

V.4 Sigurimi i kontratës: 10% e vlerës së kontratës, me afat të validitetit për periudhën në kohëzgjatje prej 25 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

V.5 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 07.11.2023, ora 14:30. Vendi: Objekti i BQK-së, Rr. "Garibaldi" nr. 33., Prishtinë.

V.6 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 07.11.2023, ora 14:30. Vendi: Objekti i BQK-së, Rr. "Garibaldi" nr. 33., Prishtinë.

VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë në dispozicion në: www.bqk-kos.org


VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë BQK-së brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve kalendarikë nga shpallja e njoftimit përkatës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Garibaldi 33, 10000 Prishtinë

www.bqk-kos.org



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "VG Construction Plus" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810198243.

- Kreshnik Kusari, nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Alush Ibush Sllamniku, shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "28 Nëntori" Prishtinë.

- Jamin Janovali B.I. shpall të pavlefshme certifikatën TVSH-së, me nr. 330022484.

- Mentor Muçaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Pjeter Budi" Lubizhdë e Hasit.

- Arlinda Halili shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Hilmi Bahtijari" Blaq, Dragash.

- Blerim Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V SHFMU "Dy Dëshmorët" Piranë.

- Aferdita Ferati shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Dy Dëshmoret" Piranë.

- Adisa Rama shpall te pavlefshme dëftesat e kl X,XI,XII,XIII të SHFMU "Luciano Motroni" Prizren.

Ujëvara Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e testit të maturës të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi".

Liberta Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

Edmonda Kadriu shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Xheladin Deda".

Urimi Rent a car shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811430941.

Aksa Advertiment SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811284299.

Besart Sadiku B.I. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810174673.

B2 SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit nr. 810129347.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

